

Komuna debaton me qytetarët ekzekutimin e buxhetit të vitit 2011 - 10 shkurt 2012

<http://kk.rks-gov.net/kacanik/News/Komuna-debaton-me-qytetaret-ekzekutimin-e-buxhetit.aspx>



Komuna e Kaçanikut dhe Projekti Zvicër – Kosovë për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim, LOGOS, e kanë organizuar debatin me qytetarë me temë: Ekzekutimi i buxhetit komunal për vitin 2011



Komuna e Kaçanikut dhe Projekti Zvicër – Kosovë për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim, LOGOS, e kanë organizuar debatin me qytetarë me temë: Ekzekutimi i buxhetit komunal për vitin 2011.

Të pranishëm ishin edhe kryetari i komunës z. Xhabir Zharku dhe koordinatoren i projektit LOGOS, z. Norbert Pijls.

Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku ka thënë se qytetarët e kanë vlerësuar punën tonë dhe së bashku iu kemi gëzuar realizimit të projekteve në komunën tonë. Edhe me këtë rast kryetari Zharku ka kërkuar nga qytetarët e pranishëm që të bëjnë vlerësimin e shpenzimit të buxhetit për vitin që e lamë pas. “Kërkoj që edhe në këtë debat të bëni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja për shpenzimin e parasë publike për vitin 2011” u ka thënë qytetarëve të pranishëm, z. Zharku.

Ndërkaq z. Norbert Pijls, koordinator i projektit LOGOS u shpreh se përmes këtij debati ne synojmë të arrijmë dy objektiva: ngritjen e transparencës, që nënkupton informimin tuaj se çfarë po bënë komuna me parat tuaja dhe objektivi i dytë: ngritja e llogaridhënies. Prezantimin e ekzekutimit të buxhetit komunal për vitin 2011 e ka bërë z. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit. Drejtori Vërbani ka thënë se Draft buxheti për vitin 2011 që miratuar në shtator të vitit 2010, në shumë prej 4,754,340 euro ndërsa gjatë vitit ka pësua ndryshime, përkatësisht është rritur për 1,061,709 euro dhe përfundimisht në fund të vitit 2011 ka arrit shumën 5,816,049 euro. Buxheti i shpenzuar ishte në shumë prej 5,592,558 euro që paraqet një ekzekutim prej 96, 2 % . Shpenzimi i buxhetit të vitit 2011na raport me atë të vitit 2010 ka shënuar rritje për 27 % dhe në raport me atë të vitit 2009, rritje për 37,3%.

Buxheti i shpenzuar për vitin nga granti qeveritar ishte në shumë 4,935,667 euro ose 88, 2 %, nga të hyrat vetjake komunale në shumë prej 592,096 euro ose 10,8 % dhe grante tjera e donacione në shumë prej 64,825 euro ose 1,2 %. Drejtori Vërbani tha se sipas sektorëve shpenzuesi më i madh ishte sektori i arsimit në shumë prej 2,824,344 euro ose 50, 5 %, pastaj administrata komunale në shumë prej 2,115,817 euro ose 37,8 % dhe shëndetësia e mirëqenia sociale me 652,427 euro ose 11, 7 %.

Drejtori u shpreh se për 100 euro të mjeteve buxhetore të destinuar për shpenzime, 63,60 euro kanë shkua për paga, 25,80 për investime kapitale, 7,70 euro për mallra e shërbime, 1,50 për shërbime komunale dhe 1,30 euro për subvencione. Z. Vërbani tha se në fondin e buxhetit të Republikës së Kosovës, nga buxheti i komunës sonë është kthyer shuma prej 3,965 euro ose 0,07 %, që paraqet një mbetje shumë simbolike. Qytetarët në vazhdim të ndarë në dy grupe punuese kanë analizua të hyrat vetjake komunale dhe investimet kapitale.

Grupi për të hyrat vetjake ka nxjerr këto konkluzione:

- Taksat nga pasuria pyjore të shfrytëzohen në proporcion 50 % me 50 % me nivelin qendror,
- Të aplikohet tatimi në patundshmëri
- Komuna të vjel taksat nga resurset natyrore si nga rëra, zhavorri e gurët
- Të aplikohen taksa për veprimtarit e turizmit
- Taksat nga qiraja të vjelët nga komuna
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë
- Të lirohen bizneset nga pagesa e tarifave dhe ngarkesave

- Qeveria t'ua kthen komunave në menaxhim fondin për emergjenca dhe
- Të rishikohen kriteret për përcaktimin e tatimit në pronë

Ndërkaq Grupi për investime kapitale ka nxjerr këto konkluzione:

- Rritja e fondit për bashkëfinancim t projekteve
- Rritja e transparencës gjatë implementimit të projekteve dhe fazës së tenderimit
- Komuna të kërkoj garancion nga kompanitë që kontraktohen për realizimin e projekteve
- Të kenë prioritet projektet nga sektori i bujqësisë dhe
- Prioritet të iu jepet projekteve që janë në shërbim t nevojave më vitale për qytetarët
- Kryetari Zharku e ka vlerësuar të frytshëm debatin me qytetarë dhe e ka çmuar angazhimin dhe kontributin e tyre. Kryetari u zotua se Komuna do ti mbështet konkluzionet e dala nga qytetarët por vetëm duke respektuar ligjin ndërkaq edhe z. Pijls e ka vlerësuar si shumë të suksesshëm debatin ndërsa ka thënë se i ka pëlqyer grupi që ka debatuar për të hyrat vetjake pasi që, siç tha ai, grupi u angazhua se si komuna të ngrit të hyrat buxhetore.